

SEJDI M.GASHI

KONTRIBUTI I RAJKO NAHTIGALIT PËR GJUHËN SHQIPE

811.18(091)

Abstrakti: Në këtë punim kemi marrë në shqyrtim kontributin e linguistit sloven Rajko Nahtigal për shqipen dhe shqiptarët.

Siç dihet, ndihmesat e albanologëve të huaj për shqipen, në të gjitha drejtimet janë të shënuara në historinë e albanologjisë përgjithësisht, por rasti i slovenit, Nahtigal është i veçantë, sepse ai u angazhua edhe në Komisinë Letrare Shqipe të Shkodrës (1916-1917), ngjarje kjo prej më të rëndësishmeve për fatin e shqipes. Prandaj, ky studiues sipas nesh paraqet një interes të veçantë për albanologjinë përgjithësisht e për shqipen veçanërisht.

Fjalët çelës: Rajko Nahtigal, Komisia Letrare Shqipe e Shkodrës, albanologjia, variant gjuhësor i përbashkët.

Siç dihet, interesimet e të huajve për shqipen dhe shqiptarët tashmë janë të një tradite të lakmueshme, pjesë e së cilës janë edhe studiuesit sloven. I pari prej tyre është Jernej Kopitar, i cili më 1829 bëri një studim lidhur me shqipen, vllahishten e bullgarishten (*Jahrbrücher der Literatur*), ndërkaq pak më vonë në skendë shfaqen edhe studiues të tjerë si: Mikloshiqi (*Albanische Forschungen* 1870), pastaj sllavisti dhe komperativisti Karel Oshtiri, i cili e studioi shqipen me qëllim, që përmes leksikut të saj të hap shtigje drejt njohjes së gjendjes gjuhësore paraindoevropiane në Ballkan (**Jakopin 1977:221**). Përveç të përmendurve, një tjetër sloven, që një pjesë të mirë të jetës së tij ia kushtoi shqipes dhe shqiptarëve është edhe Rajko Nahtigal. Ky albanolog sloven kishte studiuar në seminarin e sllavistikës, pranë Universiteti të Vjenës, ku studione edhe i riu shqiptar Gjergj Pekmezi. Prandaj, Nahtigali aty u njoh me Pekmezin e që, më vonë do ta ketë njërin prej miqve më të mirë. Në dobi të kësaj flasin shumë letra që Nahtigali i kishte shkëmbyer me Gj. Pekmezin dhe Ivan Prijatelin (historian dhe letrar i shquar sloven) gjatë kohës sa kishte qëndruar në Rusi (1901-1902).

Vendosmëria e Nahtigalit që të merrej me shqipen dhe shqiptarët, sipas gjasash është shtuar edhe më shumë kur i ra në dorë studimi i Gajlerit mbi alfabetin shqip e sllav (1833) nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, ishte pikërisht atmosfera dhe entuziazmi që e kishin krijuar veprat e Gustav Meyerit; *Fjalori etimologjik* (1891) dhe *Gramatika shqipe*.

Nga ana tjetër, ndërkohë, Gjergj Pekmezi kishte ardhur në Shqipëri, me qëllim që të mblidhte lëndë gjuhësore për studimet e tij, të cilat ia kishte prezantuar Nahtigalit. Prandaj, konsultimi i kësaj lëndë gjuhësore nga Nahtigali i mundësoi atij që të jepte kontribut të theksuar edhe në përgaditjen e *Gramatikës shqipe* të Pekmezit. Megjithëkëtë, Nahtigali ishte i vetëdijshëm se kontributi i tij, por edhe i mikut të tij Gjergj Pekmezit, rreth vetëm disa problemeve të caktuara gjuhësore të shqipes, nuk ishte i mjaftueshëm, sepse nevoja që shqiptarët të kishin një shqipe të përbashkët ishte fort e ngutshme. Prandaj, ata ("Pekmezin e Nahtigalin) nuk i kënaqnin as disa punime albanologjike që hidhnin dritë mbi gjuhën e toskëve e të gegëve, përderisa ato drejtëpërdrejtë nuk merrnin në trajtim çështjen e gjuhës së përbashkët letrare shqipe" (**Jakopin 1977:223**). Atyre viteve, në Shqipëri disa procese kishin filluar të dinamizoheshin, prandaj priteshin ndryshime të caktuara. Kështu, menjëherë pas vitit 1913, për shkak të rrethanave të reja politike të krijuara, çështja e gjuhës së përbashkët shqipe u bë edhe më e nevojshme, edhe më e domosdoshme dhe tani rendi e kërkonte që kësaj çështjeje t'i rrekeshin të gjithë ato

personalitete që e njihnin situatën gjuhësore në Shqipëri. Për këtë arsye autoritet shqiptare të kohës, me ndihmën edhe të austro-hunagrezëve, në shtator të vitit 1916, thirrën një tubim me karakter gjithëkombëtar, ku do të diskutohej çështja, ende e pa zgjidhur e gjuhës shqipe, takim ky që në histori njihet me emrin Komisia Letrare Shqipe e Shkodrës.

Për sa i përket kësaj ngjarjeje me rëndësi për Kombin Shqiptar, sipas procesverbalit nga mbledhja e parë e KLSH-së si dhe broshurës së botuar më pastaj në organin “*Laimet e Komisisë Letrare Shqipe*” Shkodër, 1918, shënohet si datë themelimi 1 shtatori i vitit 1916, kur u mbajt mbledhja e parë, ndonëse statuti në versionin e parë mund të jetë miratuar më parë. Ekziston edhe një mendim tjetër sipas të cilit kjo Komisi duhet të jetë themeluar nga fundi i gushtit të vitit 1916 (Kanini, 2001:133).

Organizimi dhe mbajtja e Komisisë së Shkodrës u bë në rrethana dhe kushte tejet komplekse, megjithëkëtë, ky tubim në historinë tonë mbetet një prej ngjarjeve më të rëndësishme dhe më serioze në përpjekjet e pareshtura për përcaktimin e një varianti gjuhësor të përbashkët për të gjithë shqiptarët. Kështu, ky tubim vuri në lëvizje procesin e konvergjencës gjuhësore si dhe u hapi rrugë një varg ngjarjesh me rëndësi për të ardhmen e shqipes. Prandaj, në këtë plan, Komisia kishte vendosur që parësore ta ketë shqyrtimin e situatës gjuhësore si dhe të shihte mundësitë që mund të buronin nga kjo situatë, sepse para vetës Komisia kishte pak mundësi veprimi; ose ta lejonte zhvillimin e lirë të dy dialekteve në mënyrë paralele dhe pastaj të shihet se cili prej tyre do të jetë më produktiv, që më pastaj po nga ai dialekt (duke i shtuar edhe pak elemente nga tjetri) të krijohet shqipja standarde, kurse mundësia e dytë ishte që të ndiqeshin praktikatat e gjuhëve tjera, siçdomos ato fqinje, fjala ishte për serbokroatishtën . Në këtë rrafsh, Komisia parimisht vendosi që varianti, i cili do të vihej për themel të shqipes letrare të jetë e folmja e Shqipërisë Qëndore, përkatësisht e folmja e Elbasanit. Natyrisht, një vendim i tillë kërkonte arsyetimet e nevojshme veçmas, ato gjuhësore. Për këtë arsye, kryetari i Komisisë së Shkodrës, dr. Gjergj Pekmezi, kërkoi që në këtë proces të ftoheshin edhe njerëz të tjerë dhe ekspertë të fushës. Kështu, në vijim “u thirr si korrespondent i Komisisë filologu elbasanas, Aleksandër Xhuvani, për të ndihmuar në përmirësimin e gjuhës standarde të zgjedhur. U mendua, që pasi të nisë punën Xhuvani, të kërkohet ndihma e një albanologu të huaj për studime në trevat ku flitej elbanishtja. Për këtë qëllim u dërgua një ekspeditë gjuhësore në Elbasan për tri javë e përbërë prej Gjergj Pekmezit, Ndre Mjedës dhe Rajko Nahtigal, në atë kohë profesor në Universitetin e Gracit të Austrisë. Pjesë e grupit që realizonte kërkimet ishte edhe Maksimilian Lamberg, i cili qe angazhuar për një periudhë kohore rreth dy muaj e gjysmë (15 mars-30 maj 1917). Kështu, pra, pas përfundimit të punës në terren, grupet punuese raportet e tyre i sollën në Komisinë Letrare për faktin se ato duhej të studioheshin dhe të analizoheshin me kujdesin më të madh. Ndonëse problemet ishin mjaft komplekse, ato u diskutuan me kujdesin e duhur dhe paraqiten interes të madh në të gjitha forcat intelektuale. Por, cilat ishin motivet dhe arsyet që e folmja e Elbasanit u zgjodh si model gjuhësor për shqipen e përbashkët? Caktimi i të folmes së Elbasanit në qendër të ortografisë së shqipës së përbashkët, nuk ishte diçka e rastësishme, për faktin se elbanishtja i plotësonte kërkesat themelore, në të cilat u mbështet edhe vendimi i Komisisë së Shkodrës. (Myrta 2014:55). Për sa i përket zgjedhjes së bazës dialektore të shqipes, anëtarët e Komisisë kryesisht bazoheshin në aftësitë e tyre shkencore e profesionale, por edhe në kontributin e anëtarëve korrespondentë të Komisisë si edhe në dijet dhe punën e dy albanologëve të mirënjohur, siç ishin M. Lambertz dhe R. Nahtigal. Ky i fundit (Nahtigali) mori përsipër që ta hulumtojë të folmen e Elbasanit me rrethinë. Më të përfunduar punën, ai hartoi një prememorinë të gjerë me titull: *Die Frage einer einheitlichen albanischen Schritsprache*, Grac, 1917. Faktikisht, studimi i Nahtigalit nuk përbënte thjesht vetëm një përshkrim të gjendjes gjuhësore, por ishte një studim i hollësishëm në lidhje me dukuritë dhe problemet e caktuara gjuhësore, qenësore këto, për krijimin e shqipes së përbashkët letrare.

Siç mund të vërehet nga studimi i Nahtigalit, aty trajtohen çështje dhe probleme të përgjithshme (disa prej tyre ishin probleme edhe përtej gjuhës), por që do të ndikonin fuqishëm në unifikimin gjuhësor të shqiptarëve.

Slloveni Nahtigal, sigurisht i ndikuar edhe dialektologjia e vendit të tij, pohoi se gjuha shqipe është e degëzuar për shkak të konfiguracionit gjeografik që ka Shqipëria, por nga ana strukturore është gjuhë homogjene. Gjithashtu Nahtigali, në qasjen e tij studimore ishte kundër çdo lloj prirjeje me karakter lokal, veçmas ndaj shkodranëve të cilët trumbëtonin më të madhe se shkodranishtja do të ishte varianti më i përshtatshëm mbi të cilin do të krijoheshin shqipja e përbashkët. Prandaj, ai në arsyetimet e tij pohoi se shkodranishtja është e folme gege periferike, që në vete përmban shumë veçori lokale, prandaj ky variant gjuhësor nuk paraqet diçka premtuese për të unifikimin gjuhësor të të gjithë shqiptarëve. Ai dha propozimin se zgjidhja duhej kërkuar në të folmet kalimtare të Shqipërisë së Mesme (Elbasani me rrethinë) sepse ajo e folme është e kuptueshme si për gegët ashtu edhe për toskët. Për këto pohime të tij, Nahtigali solli edhe argumente të mjaftueshme gjuhësore.

Dijetari slloven, ishte i mendimit se e folmja e Elbasanit parë nga aspekti sintaksor, paraqet një sintezë të shqipes autoktone, dhe është më pak e ndikuar nga gjuhët e huaja. Nahtigali propozonte edhe themelimin e një reviste, në të cilën do të publikoheshin rezultatet e kërkimeve gjuhësore në fushë të normëzimit të shqipes.

Kështu, ndihmesa e Nahtigalit për shqipen dhe shqiptarët është vlerësuar objektivisht nga shtypi i kohës, por edhe nga studiues shqiptar dhe të huaj. Në këtë drejtim po veçojmë studiuesin Xhevat Lloshi i cili pohon: “Ndihmesa e Nahtigalit është quajtur e dobishme si në vitin e vizitës në Shqipëri, edhe më pas”, ndërkaq gazeta “Posta e Shqypnics” Nahtigalin e përshkruan si një punëtor të vyer. Kjo gazetë shkruan se ai ka shtjelluar me mjeshtëri të pa shoqe pikëpamjet e veta: “*si mund të pritej prej mendjet t’kthjellt t’nji Nahtigalit. Tue botue i famshmi dienaar ket vepër, i ka ba letratyrës shqype e kombit shqyptar një shërbim t’madh.*” (Lloshi 2016).

Përfundime

Për sa i përket kontributit të Rajko Nahtigalit për gjuhën shqipe, me plot gojën mund të pohohet se ky albanolog slloven mjaft gjatë u mor me shqipen dhe shqiptarët dhe në këtë drejtim ai dha kontribut të pa zëvendësueshëm. Dashuria dhe vendosmëria e tij që të merrej me studime mbi shqinë siç u pa nga materiali që trajtuam më lart në këtë punim, sipas gjasash është rritur edhe më shumë atëherë kur ju dha rasti që ta shoh studimin e Gajlerit mbi alfabetin shqip e sllav (1833) nga njëra anë, dhe nga ana tjetër që po ashtu ndikoi në frymnëzimin e Nahtigalit, ishte edhe atmosfera dhe entuziazmi që e kishin krijuar veprat e Gustav Meyerit; *Fjalori etimologjik* (1891) dhe *Gramatika shqipe*. Ndonëse, Nahtigali dhe miku i tij, Gjergj Pekmezi, brenda një kohe të shkurtër kishin kontribuar mjaft për shqipen, ata nuk kënaqeshin vetëm me këto kontribute, sepse sipas Nahtigalit, ato më shumë trajtonin vetëm gjuhën e toskëve apo të gegëve dhe nuk merrnin drejtëpërdrejtë në shqyrtim çështjen e gjuhës së përbashkët letrare shqipe. Prandaj, duke parë këtë largpamësi të këtij dijetari slloven, me bindje të plotë mund të pohohet se kontributi i Nahtigalit në fushë të albanologjisë përgjithësisht, e në atë të shqipes veçanërisht është i pa kundshoq dhe meriton vlerësimin dhe respektin më të madh.

Bibliografia

Çeliku, Mehmet.(2009). *Çështje të shqipes standarde*, Tiranë.

Jakopin, Franc. (1977). *Kontributi i Rajko Nahtigalit shkencës së albanologjisë*, në: GjA, SShF, VII, Instituti Albanologjik-Prishtinë.

Kanini, Ilir. (2001). *Arsimi në Shqipëri, në vitet e Luftës së Parë Botërore*. Tiranë

Lloshi, Xhevat. në: <http://maqedoniashqiptare.com/2016/09/komisia-lufta-per-gjuhen/>, marrë më: 27.09.2017).

Myrta, Manola. (2014). *Në gjurmë të elbaskanishtës letrare*, Disertacion doktrature në dorëshkrim , Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë , Departamenti i Gjuhës Shqipe, Tiranë.

Osmani, Tomor. (2004) . *Komisia Letrare Shqipe në Shkodër (1916-1918)*. Shkodër.

Osmani, Tomor.& Gogaj, Nuri. (1994). *Komisia letrare shqipe në Shkodër-ngjarje me histori gjuhësore dhe kulturore*. Tiranë. "Gjuha jonë".

Posta e Shqypnis, vjeti I, nr. 95, Shkodër, 1917.

Raka, Fadil.(1997). *Historia e shqipes letrare*, Universiteti i Tetovës.

Topalli, Tefë. (1996). *Komisia Letrare e Shkodrës-Kongresi i parë drejtshkrimor i gjuhës shqipe*, botuar në: Studime shqiptare I. Shkodër. f. 151-156.